

# Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti I i Botimit. Nr. 8. Dhjetor 2006 Çmimi: 30 lekë

## "Dibrës i takon një Universitet"

Prefekti i Dibrës, Xhafer Saiti, i shkruan Ministrin të Arsimit dhe Shkencës Genc Pollo

FAQE 2

"Në prefekturën e Dibrës ndodhen tre shkolla pedagogjike, të cilat janë një mbështetje për krijimin e një dege të Universitetit, qoftë edhe ciklin e ulët, e cila do mblidhte studentë nga Kukësi e Mati, pse jo dhe nga matanë kufijve shtetërorë"

### NJOFTIM

Gazetën "Rruga e Arbërit" mund ta gjeni të plotë në internet, që nga numri i parë, në website:

[www.dibra.org](http://www.dibra.org)

Kjo u bë e mundur falë kontributit të z. Gazmend Kërkuti

### NE BRENDESI:

**Huzri Hoxha i rikthehet pikturës**

FAQE 8

**Yll, që shkëlqeu në yllësinë e personaliteteve ushtarake shqiptare**

FAQE 6

**Komuniteti dibran dhe Shoqata "Dibra" në Lezhë**

FAQE 4

**Gazmend Kërkuti, dibrani që bën të njohur Dibrën në gjithë skajet e botës**

FAQE 8

**Barbaritë serbe në Dibër e Lumë në vitin 1913**

FAQE 6

### "Të parët, qytetarët"

Intervistë me Kryetarin e Bashkisë, Peshkopi, z. Ilir Krosi



FAQE 5

### TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

**Rakip Suli, njeriu që di të bëjë jo vetëm biznes, por të vlerësojë kulturën dhe sportin dibran**

FAQE 3



## Piloti dibran që shpëtoi Lushnjen nga katastrofa

Nga SHAQIR SKARRA

Sefedin Tomçini atë natë qer Sshori kishte 35 vjetorin e lindjes. E gjithë shtëpia e tij e kishte organizuar bukur këtë festë familjare. Suzana e shoqja ishte mjaft e përkushtuar për këtë darkë jo vetëm familjare. Ishin blerë dhe dhuratat por dhe pijet e çastit. Ishin njoftuar dhe ato që do të vinin në këtë gëzim familjar. Dy vajzat e Sefedit ishin të vogla. Më e madhja Elda nuk kuptonte me këto pregaditje që po bëheshin në shtëpinë e saj. Sefedini u nis herët në mëngjez.

(FAQE 7)



### U R I M

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" u uron gjithë dibranëve ngado që janë: Gëzuar Festat!

### Safet Zhulali qytetar nderi i qytetit të Peshkopisë

Këshilli bashkiak i qytetit të Peshkopisë në mbledhjen e tij më datë 22 nëntor shpalli qytetar nderi zotin Safet Zhulali pas vdekjes me këtë motivacion: "Qytetar, mësues, sportist, intelektual shembullor, themelues i pluralizmit politik në rrethin e Dibrës, projektues dhe zbatues i integritit të Shqipërisë në NATO. Jo vetëm kaq por për të përjetuar emrin e Safet Zhulalit në qytetin e Peshkopisë, aty ku kaloj vitet më të bukura të jetës së tij një rrugë do të mbaj emrin e tij.

FAQE 5

# Safet Zhulali qytetar nderi i qytetit të Peshkopisë

Këshilli bashkiak i qytetit të Peshkopisë, në mbledhjen e tij më datë 22 nëntor 2006, shpalli qytetar nderi zotin Safet Zhulali, pas vdekjes, me këtë motivacion: "Qytetar, mësues, sportist, intelektual shembullor, themelues i pluralizmit politik në rrethin e Dibrës, projektues dhe zbatues i integritimit të Shqipërisë në NATO". Jo vetëm kaq, por për të përjetuar emrin e Safet Zhulalit në qytetin e Peshkopisë, aty ku kaloj vitet më të bukura të jetës së tij, një rrugë do të mbaj emrin e tij. Safet Zhulali, ish - ministri i mbrojtjes, i cili vdiq para pak vitesh, ende kujtohet dhe nderohet në Peshkopi si një ndër intelektualët që bënë gjithçka të mirë dhe të bukur për këtë qytet lindor.

## NJË JETË NË SHËRBIM TË DIBRËS DHE DIBRANËVE

Megjithse ka pak vite që ka vdekur, Safet Zhulali në Dibër kujtohet me mall dhe respekt. Ai vinte nga një familje intelektualësh gjirokastritë, por çdo gjë të mirë dhe të bukur e lidhi bashkë dhe në mënyrë të pandarë me Dibrën dhe dibranët, pasi këtu i kaloi vitet më të mira të jetës së tij. I janë mirënjohës të gjithë në Dibër dhe e kanë ndër dorën e tij të ngrohtë dhe në momente më kyçe. Jo vetëm atëherë, kur ishte mësues në shkollat tetëvjeçare të qytetit, por dhe kur ishte në gjimnazin e Peshkopisë, Safet Zhulali kujto-

het si një ndër mësuesit më të mirë të këtij qyteti. I thjeshtë dhe tepër i komunikueshëm me të gjithë. Rrinte me të rinj, por dhe me të moshuarit, bisedonte lirshëm sikur të ishte njohur prej vitesh dhe nëqoftëse kishte mundësi u zgjidhte dhe problemet që kishin. Respektin ua impononte të tjerëve, me sjelljet qytetare dhe intelektuale, me thjeshtësinë që e karakterizonte gjithmonë, me sinqeritetin e çiltër. Ai u bë një nga intelektualët më me vlerë në Peshkopi. Vitet nëntëdhjetë, kur në vendin tonë u legalizua pluralizmi politik, Safet Zhulali ishte ndër nismëtarët e parë të Dibrës për të krijuar degën e Partisë Demokratike në rreth. Jo vetëm kaq, por u bë dhe kryetari i saj qysh në fillim. Safet Zhulali nga vota e dibranëve zgjidhet dhe deputet në Kuvendin Popullor. U bë Ministër i mbrojtjes, por dera e zyrës së tij asnjëherë nuk u mbyll për dibranët.

Veçantia e tij ishte se nuk ka parë asnjëherë me syrin e partiakut ekstremist, por gjithmonë i ka shikuar njerzit nga problemet dhe hallet që kanë dhe ua ka zgjidhur problemet, të paktën ato dibranë që i kanë trokitur në zyrë. Kur ishte puna për të vlerësua intelektualët ai asnjëherë nuk i pa nga ngjyra partiake, por i vlerësoi nga aftësitë që kishin.

Sot në Dibër vlersimet për figurën e Safetit janë maksimale nga të dyja krahët e politikës, sepse ai ishte njeri me ekuilibër dhe një intelektual me vizione



për të ardhmen. Figura si Safet Zhulali në këto vitet e pluralizmit janë të pakta. Ai u shkëput me kujdes nga komplekset e politikës dhe iu përkushtua Dibrës dhe dibranëve pa braktisur asnjëherë detyrën që i kishin ngarkuar. Vdekja e tij e parakohshme la një shije të hidhur tek dibranët, tek ato njerëz të mirë që e deshën dhe i deshi, por ja fundja, janë përsëri dibranët ato që e përjetojnë duke e shpallur qytetar nderi të Peshkopisë.

# "Dibrës i takon një Universitet"

Në zyrën e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, zotit Genc Pollo, ka ditë që ndodhet një kërkesë e Prefektit të Dibrës për domosdoshmërinë e ngritjes së një filiali të shkollës së lartë në Peshkopi. Prefekti i Dibrës, zoti Xhafer Seiti, një intelektual nga Tepelena, është i pari zyrtar në këtë qark në 16 vite pluralizëm, që e ka ngritur këtë kërkesë me vendosmëri.

Sapo detyrën e Prefektit të Dibrës, Xhafer Seiti, një njeri me vizione dhe intelektual, u njoh realisht me problemet që kishin prefektura dhe ka nisur përpjekjet për zgjidhjen e tyre. Pas problemit emergjent të Rrugës së Arbërit, ku për këtë i dërgoi një letër edhe Kryeministrit, zotit Sali Berisha, tani shqetsohet për një shkollë të lartë në Dibër. Prefekti këtë e argumenton me faktin se në Dibër ndodhen tre shkolla pedagogjike; në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel. "Po të ngrihej një filial, qoftë dhe për ciklin e ulët, këtu do të vinin studentë jo vetëm nga Dibra, por dhe nga Kukësi, Bulqiza, Mati, dhe pse jo edhe nga viset shqiptare në Maqedoni".

Ndoshta, nga kjo kërkesë e zyrtarizuar nga prefektura, e cila tani ndodhet në zyrat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dibranët që vitin e ardhshëm do të kenë një shkollë të lartë. Fundja kjo u takon dibranëve!

*Në prefekturën e Dibrës ndodhen tre shkolla pedagogjike, të cilat janë një mbështetje e për krijimin e një dege të Universitetit, qoftë edhe ciklin e ulët, e cila do mblidhte studentë nga Kukësi e Mati, pse jo dhe nga matanë kufijve shtetërorë*



*Ish-shkolla Bujqësore, një nga mjediset ku mund të vendoset universiteti i Dibrës*

## KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: RAKIP SULI  
Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA  
Redaksia: Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi,  
Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala  
ADRESA E GAZETËS: Biloku i banesave "Gintash", Laprakë.  
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.  
Email: lid\_gazeta@yahoo.com

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në PROCREDIT BANK  
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203

## NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: (04) 357 179 ose të na shkruani në E-mail: lid\_gazeta@yahoo.com

## Reklamoni biznesin tuaj!

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!  
Tel.068 31 19 232.  
Tel: (04) 357 179.  
Email: lid\_gazeta@yahoo.com

## TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

# Rakip Suli, njeriu që di të bëjë jo vetëm biznes, por të vlerësojë kulturën dhe sportin dibran

Nuk ka njeri që ka udhëtuar nga Tirana për në Durrës, dhe të mos i ketë rënë në sy, buzë autostradës, te kilometri 9, një godinë të re dhe të bukur, me logon "Aurora Group". Por, pak prej tyre e dinë se kjo është selia e re e kompanisë, që prej 10 vjetësh drejton z. Rakip Suli.

Në 5000 metra katrorë sipërfaqe truall, "Aurora Group" ka ndërtoar godinën ku gjenden zyrat, magazinat, ekspozitat si dhe mjaft mjedise të tjera, që u vijnë në ndihmë klientëve për të zgjedhur më të mirën për shërbimet që ato kërkojnë.

"Aurora Group" ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1996, nën drejtimin e z. Rakip Suli. Aktiviteti i firmës fillimisht ishte në tregtimin e materialeve të ndërtimit, projektimit dhe zbatimit, rikonstruksion e rifinitura të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të zyrave e banesave. Shumë shpejt, "Aurora Group" shtrihet në të gjithë vendin, kjo falë cilësisë së materialeve që tregton, stafit të specializuar, duke u dhënë kështu mundësi klientëve në çdo cep të vendit të kenë pranë shërbimet dhe produktet e kompanive më të njohura në Europë dhe SHBA.

- Nga viti në vit, ne kemi patur një rritje tregu 30-40%, thotë Presidenti i "Aurora Group", Rakip Suli dhe, kjo ka ardhur si bashkëpunim i kompanisë tonë me kompanitë më prestigjioze në Europë dhe SHBA. La Farge Gips, Rigips, Knauf, Metaxiotis, Herakli, Rockfon, Bitum, Stir xps, PermaBase, Onduline, URSA, Akifix, Decora, Prat&Lambert, Isomat, Neboard, Petridis, etj., janë disa nga kompanitë, produktet e të cilave tregtohen në Shqipëri nga "Aurora Group". Përveç kësaj, "Aurora Group" ka ekskluzivitetin e USG DONN për Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë.

"Kjo rritje tregu e bashkëpunimi me kompanitë e huaja, ka dhe një anë tjetër të suksesit, e cila është korrektesa me klientët, cilësia e produkteve sipas standarteve europiane ISO 9001-2000, si dhe e stafit të specializuar në këtë fushë. Shumë punëtorë të firmës herë pas herë specializohen pranë kompanive të huaja, me të cilat bashkëpunojmë."

Prej pesë vitesh në panairin e përvitshëm, organizuar nga "Klik Eksko Klik", kompania "Aurora Grup" ka marrë pjesë si rezultat i produkteve të reja që ka hedhur në treg viti pas viti.

Rakipi nuk flet shumë për vete. Më shumë flet për stafin e tij të punës, për administratën e kompanisë, për arkitektët dhe inxhinierët, të cilët janë edukuar me punën dhe korrektesën ndaj klientëve.

Rakip Suli, megjithë sukseset e deritanishme në fushën e biznesit, mendon të shtrijë aktivitetin e tij edhe në ndërtim. Kjo, thotë Rakipi, vjen si një plan biznesi që po përgatitet nga administrata e kësaj kompanie. Kom-

## Njeriu i mbështetjeve për kulturën dibrane

Rakipi e do artin, do çdo gjë të mirë dhe të bukur që lidhet me Dibrën. Të gjithë e njohin në Dibrë se kudo ka ndihmuar. Në art e kulturë, por dhe në ujësjellësa e objekte kulturi, në sport e bamirësi të ndryshme. Prej katër vitesh është një ndër biznesmenët kryesor që sponsorizon "Oden Dibrane". Po kështu dhe klubin sportiv "Korabi" në voleyboll për femra. Lidhur me këtë, Rakip Suli nderohet nga bashkia e qytetit me motivacion: "Për kontributin e çmuar që ka dhënë në 75 vjetorin e klubit sportiv "Korabi". Lidhur me sportin, si një sportdashës i zellshëm, ka sponsorizuar dhe botimin e librit "Sporti dibran" me autor Ismet Bellovën. Jo vetëm kaq, por ka mbështetur dhe aktivitete dhe botime të tjera si "Sekretet e miseve", "Miss Dibra", etj. Rakip Suli u ka zgjatur dorën e bujarisë në momente të vështira jo vetëm dibranëve. E kjo ka një domethënie. Është pikërisht ajo bujari e të parëve të tij. Megjithatë dibranët nuk ia harrojnë lehtë, Rakipi tregohet më shumë se çduhet modest: nuk ka dëshirë që t'i kujtojë ato që ka bërë.



Rakip Suli (në mes) me stafin e "Aurora Group"

pania jonë do të ketë sukses edhe në këtë fushë. Kjo do sillte një harmonizim të punës së kësaj kompanie, duke e mbyllur një cikël të tërë në ndërtim, nga guri i parë i themelit deri te dekoracionet e brendshme.

Nuk është vetëm Rakipi që flet për biznesin e tij. Edhe administrata jeton me idetë e tij dhe çdo ditë sjellin ide e projekte për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Por, edhe vetë Rakipi i vlerëson administratën dhe punonjësit e tyre, di të jetojë me hallet dhe problemet e tyre. Edhe këtë vit, si vitet e tjera, ka menduar një shpërblym prej 50% të rrogës dhe 5000 lekë të reja nga një dhuratë me logon e kompanisë "Aurora Group". Jo pak, duke menduar rrogën e lartë që ata marrin në krahasim me rrogën e një zyrtari të shtetit dhe shumë kompanive të tjera private.

Për Rakipin nuk flasin vetëm punonjësit e kompanisë. Me respekt për të flasin edhe ata që e njohin. Njëri prej tyre, Defrim Methasani, thotë se Rakipi nuk është vetëm një biznesmen i suksesshëm dhe i guximshëm, por edhe një njeri me zemër të madhe. Nuk është fat vetëm për njerëzit që e rrethojnë të kenë një shok të mirë, por edhe për sportin e kulturën dibrane, të cilëve u ka qëndruar pranë. Futbollit, voleybollit e sportet e tjera dibrane kanë pasur gjithmonë mbështetjen e tij. Po ashtu, edhe "Oda Dibrane" ka pasur gjithmonë një mbështetje të Rakip Suli. Por, shton Defrimi, ai nuk ka ndihmuar vetëm Dibrën. Por në gjithë vendin kultura dhe sporti kanë gjetur mbështetje te ai. Vlen të përmendim rastin më të fundit, ku "Aurora Group", është një nga mbështesit kryesor të spektaklit "10 sportistët më të mirë të vitit 2007", organizuar nga Telesport. "Rakip Suli me virtyet e tij nderon në radhë të parë familjen e tij, miqtë që e rrethojnë dhe Dibrën" - thotë Defrim. "Koha kalon, cilësia mbetet, Aurora rritet" - mbyll vlerësimin e tij Defrimi për z. Rakip Sulin.



## JETA

Rakipi ka lindur më 22 shtator 1965 në një familje me emër të mirë në të gjithë zonën, ku është shquar për besë, bujari, burrëri dhe atdhedashuri. Shkollën fillore, tetëvjeçare dhe atë të mesmen i kreu në vendlindje. Ishte i ri atëherë kur filloi punë në administratë si dhe në pushtetin lokal të asaj kohe, por kujtimet nuk mund të shlyhen lehtë nga kujtesa. Bashkëfshatarët e kujtojnë si një djalë kurajoz, që kërkonte nga vetja, por dhe nga të tjerët. Ky virtyt e karakterizon dhe sot, ndaj deri në orët e vona qëndron në zyrë. Nga zyra largohet kur ikën dhe punonjësi i fundit. Në vitin 2001, i plotësohet dëshira për t'u arsimuar, ku mbaron Fakultetin Ekonomik. Tashmë është në vitin e dytë të Fakultetit Juridik në Universitetin "Kristal".

Rakipi është martuar në vitin 1987 dhe ka katër fëmijë. Djali i madh, Saimiri, vazhdon vitin e katërt në gjimnaz. Djali tjetër, Idajeti, vazhdon klasën e tetë. Vajza, Merjemja, është në klasën e shtatë dhe djali i vogël, që mban dhe emrin emrin e gjyshit, Bajrami, është në klasën e pestë. Rakipi është dhe një familjar dhe prind i mirë. Ai gjen kohë që të merret me edukimin e fëmijëve. Si njeri arsime-dashës, ai përpiqet për arsimimin e fëmijëve. Janë pikërisht fëmijët, ata që e çlodhin nga puna e gjatë dhe tepër e lodhshme që ka gjatë ditës. Çlodhja më e madhe për Rakipin si prind, kur sheh fëmijët e tij të dalin mirë me mësim, siç është Merjemja, e cila ka dhunti të veçanta. Ajo këto ditë nxjerr nga botimi vëllimin me poezi edhe pse është në klasën e shtatë. Poëzitë e Merjemes janë krejt filozofike.

I urojmë asaj të vazhdojë në rrugën e artit, të cilën i jati e mbështet vazhdimisht...

## PAMJE DHE PUNIMET E "AURORA GROUP"



Disa nga firmat që i kanë dhënë ekskluzivitetin e prodhimeve të tyre firmës "Aurora Group"

# Komuniteti Dibran dhe Shoqata "Dibra" në Lezhë

Nga FATMIR DELISHI\*



Stema e shoqatës "DIBRA" në Lezhë

Jemi mbledhur në këtë takim festiv, për të promovuar krijimin e Shoqatës "Dibra" në qytetin e Lezhës, që datëlindjen e saj e ka më datën 31 mars 2006, dhe njohjen e saj ligjore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datën 15 shtator 2006.

Krijimi i kësaj Shoqate është frut i mundit dhe përpjekjeve të të gjithë komunitetit dibran që jeton në rrethin e Lezhës. Ideja për organizimin e këtij komuniteti ishte hedhur nga mezi i viteve '90 nga një grup nismëtarësh të përbërë nga zotërinjtë Rasim Hoxha, Mehmet Çuku, Qazim Prejsi, Shefik Avdija, Naim Hajdari, Vehpa Topuzi, Ferit Çerpja, Shpëtim Salku, Lirim Torba, Syri Damzi, Hasan Kaloçi, Mersin Xhari, Novruz Bare, Gëzim Deda, Shemsi Kaci dhe Edmond Fida, të cilët në Mars të vitit 2005 ngritën një komision për përgatitjen e Mbledhjes së përgjithshme të datës historike të 31 marsit 2006.

Mbledhja e Përgjithshme, si organi më i lartë i shoqatës, në mbledhjen e parë të saj zgjodhi organet drejtuese, Kryesinë e përbërë nga 21 anëtarë përfaqësues të të gjitha trevave të Dibrës, dhe Bordin Drejtues prej 4 anëtarësh.

Kryetar i Shoqatës Dibra u zgjodh z. Fatmir Delishi, sekretar z. Mehmet Çuku dhe Zef Doçi e Hasan Muça nën kryetare.

Ky komunitet ka ardhur në Lezhë që apra 300 vjetësh dhe ka vazhduar mbas viteve '40 të shekullit të kaluar, kryesisht ushtarake, nëpunës dh epunëtorë të kualifikuar. Lëvizja më e madhe ka ndodhur mbas viteve '90, ku fitorja e demokracisë solli dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve. Kushtet e vështira ekonomike në trevat e tyre, mbështetja e të afërmit e tyre në rrethin e Lezhës, klima e mirë dhe mundësitë më të madhe për punë dhe biznes, qenë ndër faktorët kryesorë të lëvizjes së këtyre malësorëve krenarë, punëtorë dhe paqdashës drejt tokës mikpritës lezhjanë.

Komuniteti dibran, duke ardhur nga një trevë mjaft punëtorë, u shtri përgjatë gjithë fushës së rrethit të Lezhës, që nga Pllana, Zejmeni, Treshi, Talja, Shënkollu, Ishull Lezha dhe Shëngjini, e deri në Balldre, Torovicë e Gjadër. Por përqëndrimi më i madh i këtij komuniteti është në qytetin e Lezhës me rreth 200 familje dhe në Balldre të ri me 70 familje. Numri i komunitetit dibran drejt Lezhës vjen vazhdimisht në rritje.

Ju bëjmë me dije se ky komuniteti, prej rreth 300 familjesh, është prejardhur më së shumti nga zonat e Lurës 70 familje, Golloborda 50 familje, Maqellarë-Melan 40 familje, Reç-Dardhë 30 familje, Bulqizë-Zerqan 30 familje, Shupenzë 25 familje, Selishte-Muhurr-Qafmuhurr 25 familje, Peshkopi-Tomin-Kastriot 20 familje, Fushë-Allie-Sillovë 20 familje dhe Luzni 15 familje.

Komuniteti dibran është mirëpritur jashtëzakonisht mirë nga komuniteti vendas, janë mirëkuptuar dhe jetojnë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie të shkëlqyera kanë bërë të mundur që ndërmjet dy komuniteteve të lidhen dhe një numër i madh bashkimesh familjarë. Të njëjtën harmoni komuniteti ynë ka mbajtur dhe me komunitetet e tjera, që bashkëjetojnë në territorin e Lezhës.

Harmoni dhe mirëkuptim, tolerancë dhe paqe që ka afruar vazhdimisht komuniteti dibran, ka bërë të mundur që asnjë anëtar i komunitetit tonë nuk është bërë problem apo të jetë dënuar gjatë këtyre viteve të vështira të tranzicionit. Përkundrazi, komuniteti ynë i është përvësuar punës dhe konform ligjeve të ekonomisë së tregut zhvillon një biznes të ndershëm dhe të suksesshëm, ku në biznesin e vogël operojnë 30 subjekte dhe në biznesin e madh 15 subjekte. Krahas të ardhurave që sigurojnë për familjet e tyre ato kanë të punësuar mbi

100 punëtorë, anëtarë të shoqatës apo të komuniteteve të tjera.

Prania e të ftuarve nga institucionet kryesore të rrethit dhe jashtë saj, miqtë dhe dashamirësit e shumtë që janë të pranishëm në këtë sallë, është një vlerësim i madh dhe një mbështetje e fuqishme që i jepet këtij komuniteti dhe Shoqatës "Dibra".

Në bazë të Statutit, në këtë Shoqatë mund të hyjë çdo shtetas shqiptar apo i huaj, i aftë nga ana mendore, që nuk është "non grada" nga kombi ynë apo komuniteti ndërkombëtar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, pavarësisht nga gjendja shoqërore, familjare, bindja politike, seksi, raca, feja, arsimit, që pranon Statutin dhe paguan rregullisht kuotizacionin e saj.

Çdo anëtar që plotëson kriteret e mësipërme, pranohet në Shoqatën "Dibra" – Lezhë, në mënyrë individuale, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, duke ju drejtuar Kryesisë me një kërkesë me shkrim, kërkesë e cila miratohet brenda një muaji.

Qëllimi i organizimit të kësaj Shoqate është

- Njohja, ruajtja dhe zhvillimi i traditave, zakoneve dhe virtuteve më të mira të trevës së Dibrës dhe asaj kombëtare.

- Njohja e figurave historike, të kulturës, të artit, të shkencës, të sportit dhe atyre shoqërore, të trevës së Dibrës dhe asaj kombëtare, nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve të ndryshme që do të zhvillojë Shoqata.

- Ndhimë dhe përkrahje anëtarëve të shoqatës dhe të shoqatave homologe që janë në nevojë, që kërkojnë përkrahje morale, shoqërore apo materiale.

- Rritja e përgjegjësisë qytetare të komunitetit, për t'u bërë një faktor paqe, bashkimi e vëllazërimi ndërmjet komuniteteve.

- Rritja e përgjegjësisë qytetare të komunitetit, për t'u bërë faktor pozitiv në vendimarrjen e organeve të pushtetit vendor dhe mbështetje në zbatimin e tyre.

Të ardhurat e shoqatës do të sigurohen nga kuotizacionet e anëtarësisë, financimi i biznesmeve të shoqatës ose jashtë saj, donatorët e ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, si dhe nga aktivitetet kulturore artistike të shoqatës.

Këto fonde do të përdoren:

- Për anëtarët e shoqatës apo shoqatave analoge, familjet e të cilëve janë në nevojë ekonomike, raste fatkeqësish familjare, të natyrës njerëzore apo natyrore

- Organizime aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive

- Takime jubilarë të shoqatës

Data 31 mars 2006 shënon datën e krijimit të Shoqatës "Dibra" – Lezhë dhe data 15 shtator 2006 njohjen zyrtare të saj.

Periodha midis këtyre dy datave ka qenë një periudhë e ngjeshur për përbushjen e detyrave të përcaktuara në programin afatshkurtër të Shoqatës.

U përpunuan dhe u përfunduan në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore

## KRIJOHET SHOQATA "DIBRA" NË LEZHË

Me iniciativën e një grupi nismëtarësh dibranë të përbërë nga z. Rasim Hoxha, Qazim Prejsi, Mehme Cuku, Vehap Topuzi, Naim Hajdari, Nevruz Bare, Shefik Avdija, Hasan Kaloçi, Shpëtim Salku, Syri Damzi, Lirim Torba, Ferit Çerpja, Mersin Xhari, Gëzim Deda, Edmont Fida dhe Shemsi Kaci, në mars të vitit 2005 u konkludua në mes tyre për të krijuar Shoqatën "Dibra" në Lezhë, duke përfshirë të gjithë të ardhurit nga zonat e ndryshme të Dibrës, që aktualisht janë vendosur me banim në trevën e Lezhës.

Në këtë takim, që në fillim u bë e qartë se kjo shoqata do të kishte si objektiv:

- Të njohë dhe të promovojë ndjenjat e patriotizmit, kulturës, traditave, zakoneve e folklorit dibran.

- Të njohë, të studiojë e propagandojë historinë që në lashtësi e në ditët tona, figurat e shquara të luftës dhe të penës, t'i ruajë dhe transmetojë ato si mjet i fuqishëm identiteti për brezat e tanishëm dhe për ato që do të vinë mbas nesh, duke rritur frymën e solidaritetit dhe harmonisë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin.

- Të qëndrojnë sa më pranë njerëzve në nevojë, që për arsye të ndryshme kërkojnë ndihmë e përkrahje morale, shoqërore e materiale.

- Krahas objektivave që përmenden shkurtimisht më lart, në këtë takim u vu theksi që në gjithë veprimtarinë e saj, shoqata të jetë larg manifestimeve të ndjenjave të lokalizmit krahinor, duke mos krijuar ndasi krahinore, por të shërbejë si shembull i mirë në forcimin e unitetit në mes tyre.

Në këtë takim u ngulmua shumë që shoqata të mos influencohet apo të përfshihet në rrjedhat politike të kohës, mbasi ky veprim do të zbehte objektivat e do të çonte deri në shuarjen e saj.

Ky ngulmim u bë nisur nga eksperiencia e hidhur e disa viteve më parë, ku disa iniciues nismëtarë, kërkonin ta përdornin shoqatën për qëllime politike, lidhur nga interesat e tyre personale. Kështu ato janë mbledhur disa herë në mbështetje të ndonjë deputeti apo pushtetari vendor, por dibranët që shkonin në këto takime, sa shihnin qëllimin e tyre, pa bërë polemika largoheshin, duke u transmetuar, këtyre iniciuesve se nuk do të bëheshin vegël e askujt.

Grupi nismëtar, mbas këtij takimi ndau detyrat në mes veti dhe në fillim bënë evidentimin e familjeve dibrane në gjithë trevën e Lezhës, nga fshati Pllana e deri në Torovicë, Shëngjin e Gjadër, Balldre, duke përfshirë dhe vetë qytetin e Lezhës. Në këtë punë voluminoze u shqua anëtarë i grupit nismëtar z. Mehmet Cuku, të ndihmuar dhe nga Shefik Avdija, Syri Damzi, Lirim Torba, Hasan Kaloçi etj.

Në takimin e radhës, ku ishin ftuar dhe disa figura të tjera dibranësh,

- Akt Themelimi, Statuti dhe Programi i Shoqatës

- Stema, Vula dhe librezat e anëtarësisë

- Organizimi i anëtarëve të Kryesisë sipas reaksioneve, me detyrat përkatese

- Organizimi i Shoqatës në nëndegë, në bazë lagjeje dhe Komune

- Evidentimi dhe regjistrimi i gjithë anëtarësisë, sipas nëndegëve.

Mbas miratimit të Shoqatës në Gjykatë jemi angazhuar në shpërndarjen e librezave të anëtarësisë dhe mbledhjen e kuotizacioneve për vitin 2006.

Gjithashtu kemi dërguar njoftimet zyrtare në institucionet kryesore të rre-

si Fatmir Delishi, Zef Doci, Hasan Muca, Sami Deda, Shaban Mziu, Destan Meha, Astrit Moriseni etj. u konkludua që në bazë të madhësisë të numrit të të ardhurve për çdo zonë, të përcaktoheshin dhe përfaqësuesit e tyre që do të zgjidheshin në kryesinë e kësaj shoqate.

Në takimin e nëntorit 2005 u përkushtuan detyrat për përgatitjen e Mbledhjes së Përgjithshme mbarë dibrane në trevën e Lezhës, ku do të diskutoheshin projekt-statuti, akt-themelimi dhe projekt-programi i shoqatës "Dibra", të cilët do të hidheshin në diskutim e aprovim.

Gjithashtu, u bë dhe projekti për numrin e mundshëm në shkallë zone dhe në total, të anëtarëve të kryesisë së shoqatës. Për këto mendime të vlefshme dhanë Vehap Topuzi, Naim Hajdari, Ferit Çerpja në formulimin e listës paraprake.

Në kryesi do të bënin pjesë persona me reputacion nga zonat nga ku kishin ardhë dhe që e ruanin atë edhe këtu në Lezhë, me intelektualë, biznesmenë, pensionistë etj.

Periodha e mbetur deri në datën e krijimit të shoqatës ishte e mbushur me detyra të ngjeshura për përgatitjen e materialeve që do t'i paraqitej anëtarësisë, saktësinë e listave dhe shpërndarjen e ftesave dhe kontakti kokë më kokë me çdo anëtar të shoqatës. Veçanërisht në këtë periudhë, krahas anëtarëve të përmendur më sipër, u shqua z. Fatmir Delishi, i cili përgatiti të gjithë projektin e dokumentacionit ligjor që do t'i paraqitej për aprovim mbledhjes së përgjithshme.

Kështu, e gjithë puna e bërë me përkushtim nga ky nismëtar dhe nga ata që ju bashkuan më pas, u arrit që me dt. 31 mars 2006, me unanimitet të plotë të krijohet Shoqata "Dibra" në Lezhë.

Në këtë mbledhje të Përgjithshme, krahas aprovimit të statutit, akt-themelimit dhe programit të shoqatës u bënë zgjedhjet për kryesi, dhe bord drejtues. Kryesia përbëhej nga 21 anëtarë dhe konkretisht: Zef Doci, Astrit Moriseni, Sami Deda, Shaban Mziu, Nevruz Bare, Qazim Prejsi, Selaudin Cekici, Hasan Kaloçi, Lirim Torba, Shefik Avdija, Vehap Topuzi, Dashamir Fida, Mehmet Cuku, Fatmir Delishi, Destan Meha, Imer Keta, Naim Hajdari, Hasan Muca, Syri Damzi, Rasim Mera dhe Sajmir Hyra.

Në bordin drejtues të shoqatës u zgjodhën Fatmir Delishi - kryetar, Zef Doci e Hasan Muca – nënkryetarë dhe Mehmet Cuku – sekretar.

Përveç kryesisë së shoqatës u zgjodh dhe Komisioni i Kontrollit Financiar, të përbërë nga Shpëtim Salku – kryetar, Ferit Çerpja – nënkryetar dhe Edmond Fida – anëtar.

Përgatitur nga: Qazim Prejsi

thit, për të bërë të njohur krijimin dhe legalizimin e kësaj Shoqate, dhe ky takim i sotëm, i shërben më së miri, jo vetëm njohjes, por dhe mbështetjes që ka dhe do të ketë kjo Shoqata nga ana e institucioneve të rrethit, deputet, komunitetet fetare, partitë politike, shoqatat analoge, miqtë dhe të ftuarit e pranishëm.

Të jeni të bindur se ky komunitet, të bashkuar rreth kësaj Shoqate, do të jetë një faktor pozitiv në drejtim të forcimit të paqes, bashkimit, vëllazërimit, tolerancës dhe harmonisë ndërmjet të gjithë komuniteteve që bashkëjetojnë në Lezhën e "Besëlidhjes".

\* Kryetar i Shoqatës "Dibra" në Lezhë

# “Të parët, qytetarët”

Intervistë me Kryetarin e Bashkisë, Peshkopi, z. Ilir Korsi

Si fillim desha t'ju uroj per rikandidimin tuaj per postin e Kryetarit te Bashkise Peshkopi, dhe desha t'ju pyes si e pritet kete vendim te Kryesise se PDSH?

Ju falenderoj per urimin tuaj te perzemert, e me kete rast dua te falenderoj gjithë ata qytetare te Peshkopise e me gjere qe, sapo moren vesh rikandidimin, shpejtuan te me uronin. Çeshte e verteta, une ndjehem shume i respektuar qe mes atyre kandidatëve dinjitoze, qe dergoi Kryesia e deges se PD Diber, u zgjodha une. Nepermjet kesaj interviste deshiroj te falenderoj Kryesine e PDSH per vleresimin e punes sime dhe besimin e treguar ndaj meje si dhe ne menyre te veçante desha te falenderoj shoket e koleget e mi konkurente qe garuan aq fisnikerisht ne kete etape perzgjedhjeje.

Prej tre vjetesh ju drejtoni Bashkine e Peshkopise. Cilat kane qene problematikat me te cilat ju jeni perballuar dhe disa nga arritjet kryesore?

Fillimi ishte shume i vesh-tire. Ne trasheguam nga administrata socialiste nje borxh prej rreth 25 milion lekesh te reja. Pra, per arsye elektorale ishin bere shpenzime pa siguruar mbeshetjen ligjore financiare. Keshtu qe borxhlinjte benin presion dita dites per te kerkuar parate qe u takonin. Klima konfliktuoze qe karakterizoi zgjedhjet dhe nervozizmi qe pershkoi te majten per humbjen, u transplantuar edhe ne veprimtarine e keshillit bashkiak, ku motoja kryesore e keshilltareve te majte ne shumice ishte bllokimi, shantazhi, nervozizmi dhe pengimi i veprimtarise normale te keshillit. Rast unikal ne historine e push-teteve vendore ishte mosmiratimi i buxhetit per mese nje vit. Por veshtiresia me e madhe ishte qendrimi gati armiqesor i qeverisjes qendrore te asaje kohe, e cila pas buzqeshjeve dinake e cinike, realizonte izolimin e bashkise nepermjete nje mungese totale fondesh e grantesh. E megjithese ne ato kushte te renda bllokimi, administrata e bashkise, ndoshte e re dhe me nje pervoje te paket, punoi me perkushtim dhe pa paragjykime. Ne saje te projekteve dhe programeve te hartuara nga administrata, u terhoq vemendja e organizatave dhe donatoreve nderkombetar, te cilet i falenderojme per kontributin qe dhane per qytetaret e Peshkopise ne ato dite te veshtira. Keshtu me mbeshetjen kryesisht te donatoreve te huaj, ve vitin 2004 u realizuan rreth 350 mije Euro per permiresimin e infrastruktures dhe te sherbimeve, ndersa ne vitin 2005 me perpjekjet tona dhe me nje qendrim tashme objek-



**Përparësi do të kemi në rritjen e ndjeshmerisë tek qendrat vendimmarrëse për zbatimin e projekteve të “Rrugës së Arbërit”, si një korridor që nuk do t’u shërbejë vetëm dibranëve, por do të afrojë Europën Juglindore me atë Qendrore e me tej”**

tiv e realist te qeverise realizuam rreth 725 mije Euro po per per infrastrukture dhe permiresime sherbimesh. Gjithashtu ne dy vitet e para likujduam rreth 60% te borxheve te trasheguara nga administrata paraardhese. Si rezultata i decentralizimit real, qe eshte nje komponente e vazhdueshme e programit qeverises, dhe perkujdesjes se perhereshme te qeverise aktuale per qytetin e Peshkopise, vetem per vitin 2006 u dhane rreth 900 mije Euro per permiresimin e infrastruktures, realizimi i te cilave ka ndryshuar teresisht pamjen e qytetit dhe ka rritur ndjeshem besimin e respektin e qytetareve per qeverisjen vendore dhe ate qendrore.

**z. Ilir, nga sa kemi pare vete personalisht e nga sa jemi informuar, ne qytetin tuaj po behet nje investim goxha i madh per furnizimin me uje te pijshem te qytetareve. A mund te na thoni diçka me ne hollesi lidhur me kete investim ?**

Ne te vertete, ky investim prej afro 3 milion dollaresh, esh-

te ne perfundim e siper dhe zgjidh nje here e pergjithmon nje nga nevojat me jetike te qytetareve. Ne prag te vitit te ri 2007, qytetaret e Peshkopise do te ndahen perfundimisht nga mungesat dhe racionimi i ujit. Me se fundi, ata do te kene te ralizuar nje nga endrrat e tyre te perhereshme : sigurimin e ujit te pijshem. Per kete falenderojme edhe Banken Islamike per Zhvillim qe beri te mundur financimin e kesaj vepre madhore per qytetin tone. Ne kete menyre, ne kemi realizuar nje nga premtimet tone me te bujshme qe u patem bere qytetareve gjate fushates zgjedhore te vitit 2003.

**Meqe permendet premtimet e bera gjate fushates se kaluar, si eshte raporti mes premtimeve e mbajtjes se fjales se dhene?**

Te falenderoj per kete pyetje. Premtimet tona i beme ne dy rrafshet : - ne ate etiko-moral dhe ne rrafshin e investimeve materiale.

Ne rrafshin etiko-moral ne premtuam qe si moto dhe devize e punes sone do te jete

“Te paret Qytetaret”. Kjo devize synonte rritjen e pjesmarrjes se qytetareve ne vendimmarrje si dhe rritjen e transparences se veprimtaris se Bashkise para qytetareve. Per te realizuar kete premtim, ne riorganizuam me shpejtesi format e komunikimit me qytetaret, duke i trajtuar ato jo vetem si objekte, por edhe si subjekte veteqeverise, duke rritur ne kete menyre besimin dhe respektin e nder-sjelle. Per kete ne ngritem komisionet qytetare, u fokusuam ne debate konstruktive me qytetaret ku raportuam per buxhetin, te ardhurat, realizimin e tyre, duke kerkuar te thithim njekohesishte opsionet e qytetareve per buxhetin, per investimet, per sherbimet, infrastrukturen etj. Gjithashtu siguruam edhe ekspertizen dhe monitorimin e grupeve te eksperteve, grupeve te interesit, organizatave jofitimprurese etj. ne kete kuader, rritem progresivisht transparencen me qytetaret, te cilen e konsideronim si nje nga premtimet me te qenesishme te fushates se vitit 2003.

Ne rrafshin e investimeve materiale, realizuam plotesisht ato qe premtuam dhe konkretisht: rrugen e Kamenit, rrugen e ish SMT-se, te Llixhave; vume ne eficense fushen e mbetjeve urbane, shtuam sipërfaqet e gjelberuara dhe rritem cilesine e sherbimeve. Bile, dolem jashte parashikimeve tona dhe nderhyme e permiresuam ndjeshem infrastrukturen ne lagjet Lushe- Cipure, ne Kallavere, ne rrugat “Jashar Kola”, te Komisarariatit te Policise, te Stadiumit etj. Gjithashtu s’mund te leme pa permendur investimet ne vazhdimin e fushen e arsimit e te kultures, si: rikonstrukcioner ne shkolla,

*Në prag të vitit të ri 2007, qytetarët e Peshkopisë do të ndahen*

*perfundimisht nga mungesat dhe racionimi i ujit. Më së fundi, ata do të kenë të realizuar një nga ëndrrat e tyre të përhershme: sigurimin e ujit të pijshëm*

kopshte e çerdhe, ngritja e orkestres frymore etj.

**Ku konsiston ne vija te pergjitheshme platforma juaj per Bashkine e Peshkopise per mandatin e dyte ?**

Platforma jone do te jete ne unitet me platformen e Qeverise, per qeverisje me duar te pastra, per rritjen e permiresimin cilesor e sasiot te sherbimeve e sherbesave, per hartimin e projekteve e programeve per nxjerrjen e Peshkopise nga izolimi 50-vjeçar i shekullit te kaluar, per integrimin e saj me metropolet dhe qendrat rajonale. Ne kete kuader, une mendoj qe perparësi do te kemi rritjen e ndjeshmerise tek qendrat vendimmarrëse per zbatimin e projekteve te “Rrugës së Arbërit” si nje korridor qe nuk do t’u sherbeje vetem dibraneve, por do te afroje Evropën Juglindore me ate Qendrore e me tej. Ne do te synojme te persosim pamjen e qytetit nepermjet studimeve urbanistike, rritjes se siperfaqeve te gjelberuara, ndertimi i parkut te gjelber dhe kurores se qytetit, permiresimin e vazhdueshem te infrastruktures e sherbimeve. Ne qender te vemendjes sone do te mбетet thithja e investimeve prodhuese nga donatore te huaj dhe vendas, sidomos ne sektore te tille si ngritja e linjave te perpunimit te qumeshtit, mishit, pijeve freskuese, frutave, zhvillimi i turizmit balnear, kulturor, muzeal; zhvillimi i arsimit, kultures, sportit etj.

**Cili eshte mesazhi juaj per qytetaret e Peshkopise?**

Duke i falenderuar sinqerisht per bashkepunimin e frytshem te deritanishem, do t’u lutesha qe te me lejonin te vazhdoja t’u sherbej me mire se gjer me tani, te me lejonin te bej edhe me shume per integrimin e qytetareve te Peshkopise me njeri tjetrin, duke pasur parasysh harmonine mes qytetareve te vjeter, atyre te ardhur para viteve ’90 e atyre qe kane ardhur e do te vijne me pas. Do t’iu lutesha te me mundesonin per ta çuar akoma me perpara levizjen per kulturimin, emancipimin, dhe zhvillimin e metejsheem te qytetit tone te perbashket.

*Ju faleminderit*

Në Nju Jork, përkujtohen Dali Ndreu dhe gruaja e tij, Lirie Gega - Ndreu, 50 vjet pas vrasjes

# Yll, që shkëlqeu në yllësinë e personaliteteve ushtarake shqiptare

Na BEQIR SINA  
Nju Jork

**Royal Regency Hotel - Yonkers(NY);** Komuniteti shqiptaro-amerikan organizoi një tubim përkujtimor për të nderuar Dali Ndreun dhe bashkëshorten e tij, Lirie Gega - Ndreu, 50 vjet pas vrasjes. Gjysmë shekulli, pas ekzekutimit nga bisha komuniste ai mbetet nga figurat më të njohura shqiptare, e përbaltesur dhe e syrgjynosur nga Enver Hoxha, por e nderuar dhe e respektuar nga familja, miqtë, shokët, dhe ish kolegët e tij.

Në Royal Regency Hotel - Yonkers(NY) u mbledhën qindra bashkëatdhetarë, familjarë të familjes Ndreu, miq, fafefs, shokë, liderë fetarë dhe veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare në diasporë. Media shqiptaro amerikane, i kishte dhënë shumë rëndësi këtij aktiviteti, i cili për nga mynyra se si u zhvillua ishte një shembull i mirë kohës. Dali Ndreu u vlersua si figurë e shquar kombëtare. Njëri prej më të rinjve të familjes Ndreu, sot, mësues në Nju Jork, ish i internuar në Shtyllas, Kastriot Ndreu, udhëhoqi tubimin. "50 vite më parë, tha ai, bisha komuniste pushkatoi dy prindër, dy intelektual, dy të pafajshëm dhe kufomat e tyre, i fshehu për mos t'i gjetur familja e tyre. Që familja dhe fëmijët, të mos kishin një vend ku të bënin homazhe. Ata donin që të harroheshin, por familja dhe fëmijët kurrë nuk i harruan", shprehet Kastriot Ndreu.

Për jetën dhe veprimtarinë e tij foli edhe admiral Muharrem Kuçana, ish komandant i Flotës Luftarake Detare deri në vitin 1996, që sot jeton në Nju Jork. "Me kulturën e lartë dhe me sjelljet e mira ndaj vartësve të vet dhe popullsisë, ai fitoi respektin e tyre duke treguar se ishte biri i një familje me edukatë, me besë e trimëri e burrëri. Por ai njëkohësisht shihet me sy të keq nga të tjerët, të cilët edhe egzekutuan njëri pa gjyq, sipas, porosive e rekomandimeve të

## KUSH ISHTE DALI NDRU?

Daliu kishte lindur në fshatin Slllove të Peshkopisë, më 10 mars të vitit 1912, në familjen e shquar atdhetare të Dibres të Isuf Xhelilit, i cili kishte luftuar dhe ishte dalluar në luftërat kundër tere armiqve që kishin shkelur atdheun. Armik për vdekje ndaj politikave sllavizuese dhe i derivateve të tyre të ndryshme. Në vitin 1931, pas perfundimit të Shkolles Ushtarake të Plotësimit, në degen e artilerise, në Tirane, Daliu u titullua oficer. Ai sherbeu me graden e nentogerit, fillimisht pranë Degës së Rekrutimit në Permet, më pas, deri në vitin 1933, u caktua dhe punoi pranë artilerise së Divizionit "Kosova". Më 1937, heq dore nga karriera ushtarake dhe shkoi për të ndjekur studimet e larta për shkencat ekonomike në qytetin e Firences, në Itali. Ndodh pushtimi fashist i Shqipërisë dhe ai kthehet në atdhe, për të nisur veprimtarinë antifashiste. Me aktin e kthimit në atdhe ai tregoi se ishte luftetar i vendosur i çështjes së lirise të Shqipërisë dhe se po niste rrugen e vesh-tire, por të denje të ngjites drejt panteonit, gje që e afirmonte lufta kundër pushtuesit të huaj fashist. Çlirimi i vendit hap një kapitull të ri për Dali Ndreun. U duk sikur jeta do të sillte një të ardhme po aq të suksesshme. Në

fillim u caktua në detyra të rëndësishme dhe madje e zgjodhen edhe deputet të Dibres, qysh në Legjislaturën e Parë. Por në të vertete ky ishte kapitulli i zbehjes, i deformimit, me keq akoma, i goditjes dhe i asgjësimit të figures së mirenjohur të Dali Ndreut dhe të bashkeshortës së tij. Befas, pas gjyqit të deputeteve, gjenerali lirohet nga ushtria dhe kështu nis e tatepjeta fatale për të, rruga e mundimshme, kalvari i dyshimeve, i survejimeve dhe i ndeshkimeve të pafundme.

Kulmi arrin në vitin 1956. Behet objekt diskutimesh në konferencën e Tiranës. Menjehere pas kesaj konference arrestohet ai dhe e shoqja e tij, Lirie Gega. Kjo ndodhi më 30 gusht 1956 dhe ata perfundojne qe te dy te pushkatuar ne dhjetor te po atij viti. Akuza: "...kane vepruar aktivisht per rrezimin e pushtetit popullor". Ata se bashku me te tjeret, akuzoheshin gjithashtu se "...kane kryer agjitacion dhe propagande kunder pushtetit popullor ne menyre te organizuar dhe ne bashkepunim me personat e tjere...". Por akuza nuk ishte reale e megjithate nuk kishte rendesi pasi ajo "plotesonte kushtet per denimin me vdekje", pavaresisht se cila ishte vepra dhe ideali i tyre i vertete. Ky ishte kapitulli permbylles me i rendi dhe



me fatkeqi per Dali Ndreun. Por fakti me i rende dhe me i hidhur per nje personalitet eshte mosperfillja, mbulimi me heshtje me harrese, sidomos pas vdekjes. Keshtu ngjau edhe me kete luftetar, komandant dhe gjeneral te shquar te Luftes Antifashiste dhe te Ushtrise Shqiptare. Ai u shnderrua ne nje komandant dhe gjeneral te harruar! Tani pas dhjetora vitesh, po ngrihet kapaku i rende i harreses dhe po ringrihet e po vihet ne vend edhe figura dhe vepra luftarake e shquar e ketij personaliteti ushtarak te nje periudhe te rendesishme historike te ushtrise dhe te popullit shqiptar. Ai eshte nje yll, qe shkëlqeu ne yllesine e personaliteteve ushtarake shqiptare, qe per fat te keq u fik po aq shpejt dhe pikërisht atehere kur mund te shkelqente me teper! Por, gjithsesi, nje gje eshte e sigurt, se ai nuk do te jete me nje gjeneral dhe komandant i harruar.

serbëve", -tha zoti Kuçana. Daliu akuzohej se kishte shkuar kudo në çdo batalion për të çrrënjësuar frymën e terrorizmit komunist serb, i cili po bëhej në atë kohë veti morale e disa komunistëve Shqiptarë. Jo më pak aktive ka qënë edhe jeta e Lirisë. Ajo u perlesh dhëmb për dhëmbë me diktatorin. Për jetën dhe prejardhjen e saj - foli zonja Vojsava Ndreu, e shoqja e djalit të Daliut. Me fakte bindëse ajo tregoi se kishim të bënim me një grua, e cila rridhte nga një famil-

je me tradita të thella kombëtare.

Regjimi komunist ushtroi represionin më të egër ndaj familjes Ndreu. Genocidi ndak kësaj familjeje patriotësh të mëdhenj nisi në vitin 1946 me Cen Elezin dhe në 1956 me pushkatimin e Dali Ndreut me Lirie Gegën - Ndreun. Të gjitha familjet e Ndreu u internuan. 100- vetë ishte numri i personave që atë ditë nëndori 1958 do të internoheshin në kampet e internimit - fshatin Shtyllas(Fier) dhe qëndrat e tjera të in-

ternimit, nëpër Shqipëri. Ky numër do të rritej ndërsa shumë prej tyre lindën kampeve të internimit. Dhe disa prej tyre vdiqën edhe para kohe. Një ekspozitë të shkurtër mbi pasojat e familjes pas ekzekutimit të Daliut e bëri z.Xhevat Ndreu. Xhevati, është edhe ai njëri prej shumë nipave e mbesave të Cen Elezit, kushëri me Dali Ndreun. Ka jetuar vetë në internim në sektorin Shtyllas, deri në vitin 1991. Sot, jeton në Nju Jork.

**Këto të dhëna janë nxjerrë nga Kalendar Kombiar 1914, Sofje. Shtypshkronja "Mbrothësia", nga Sotir Kolea**

vijon nga numri i kaluar.

Në Rabdisht.

-Ky fshat u bë rrëmujë dhe u plaçkit fund e krye. U dogjën 38 shtëpi dhe përmbi 40 kasolle. Të vrarët me bajonetë janë mbi 65 veta nga të cilët me emër: Hajdar Ramadani, Myslim Osmani, Agush Ismaili, Ali Hasani, Bajram Nuredini, Ethem Sulejmani, Xhafer Hasani, Hasan Neziri, Nezir Beqiri, Azis Hasani, Haxhi Hazizi, Jusuf Demiri, Zeqir Emiri, Emin Hajrullahu, Sulejman Zeqiri, Behlul Kadriu, Ibrahim Zenuni, Qazim Behluli, Gafur Fida, Kamber Hyseni, dhe i vëllai Musai, Rexhep Abdullai, Ibrahim Farruku, dhe i ati Farruku, Halil Gafiri, Hasan Aliu dhe i vëllai Mehmeti, Ahmet Veliu, Osman Hasani, Musa Sulejmani, Rushan Myslimi, dhe i vëllai Zeneli, Emin Haku dhe i ati Demiri, Vahid Veliu, Aziz Haku dhe të vëllezrit Shqipri dhe Sulejmani, Ismail Veseli, Shaban Hasani, Hatib Bajrami, Nuredin Ibrahim dhe i ati Ibrahim, Hamit Kasemi, Dervish Aliu, dhe i vëllai Shemshedini, Ymer Xhaferi, Fejzulla Hasani, Ymer Hyseni edhe një djalë gjashtë vjetësh që e hodhën të gjallë në zjarr. Rrëmbyen 400 dele, 150 dhi, 60 lopë, 22 kuaj. Ropën dhe njerëz që nuk i vranë dhe u morën 20 lira turke.

Në Zimur.

-Plaçkitën dhe dogjën 7 shtëpi. Vranë dhe 5 veta me bajonetë: Ahmet Shabanin, Vejsel Rizanë, Milaim Elmazin, Sali

## Barbaritë serbe në Dibër dhe Lumë në vitin 1913

Shabanin, Sulejman Zeqirin dhe rrëmbyen 245 berra dhe 12 kafshë

Në Staravec.

-Bënë rrëmujë tërë fshatin dhe dogjën 42 shtëpi. Të vrarët janë: Hysen Muxha dhe Reshit Rrahmani, si dhe një grua Zobeida. Rrëmbyen 300 dhen, 30 dhi e 4 kuaj.

Në Bahutaj.

-Serbët therën Ramadan Mehmetin dhe një shokun e tij pasi i vunë të punojnë me pahir në të shtruarat e rrugës. Rrëmbyen 10 kuaj.

Në Tomini.

-Fshati i tërë u bë plaçkë dhe u dogjën 2 shtëpi, një teqe dhe një xhami. U vranë me bajonetë Masllum Jusufi dhe një djalë 10 vjetësh. E gjithë gjëja e gjallë që u ndodh në fshat u rrëmbye.

Në Dohoshisht.

-Pas të plaçkiturit të fshatit i vunë zjarrin dhe dogjën 55 shtëpi. Ndër të vrarët u shënuan emrat e Malik Bajramit, Halil Jonuzit, Ramadan Ahmetit, Musa Bajramit, Ymer Sadikut, Shaban Halilit, Zejnulla Hasanit. U rrëmbyen 400 dhen dhe 200 dhi.

Në Zagrad.

-Dogjën 8 shtëpi dhe muarën 3 kuaj.

Në Bellovë. -Bënë rrëmujë tërë fshatin.

Në Grazhdan.

-Plaçkitën e dogjën 22 shtëpi. Vranë në sy të fëmijëve Aziz Shemshedinin, Elez Hasanin, Hasan Zeqirin, Rustem Hasanin dhe të vëllanë Zeqirin, Emrulla Demirin, Bexhet Nuriun dhe të shoqen, Xhafer Jusufin, Sinan Xhaferin, Emrulla Mahmutin, Aziz Kurtishin, Ismail Xhelilin dhe të vëllanë Elezin, Tefik Beqirin, Maksut Nimanin, Hasan Durmishin. rrëmbyen gjithë

gjënë e gjallë.

Në Muhurr.

-Bënë rrëmujë tërë fshatin dhe dogjën 14 shtëpi. Rrëmbyen 200 dhen, 100 dhi, 30 lopë dhe 15 kuaj. Morën dhe përmbi 300 lira turke duke rjepur gjindjen e fshatit. Herën e dytë morën 10 dele, 10 dhi, dhe 1 kalë. Ndër të vrarët me bajoneta ishin: Hajredin Demiri, Sulejman Halili, Beqir Xhaferi, Ymer Sulejmani, Mahmut Abazi, Hysen Dervishi, Bajram Dervishi, Islam Demiri, Xhafer Ismaili, Halil Ismaili.

Në Luznie.

Pasi bënë rrëmujë gjithë shtëpitë dogjën pesë shtëpi dhe rrëmbyen gjënë e gjallë si 1500 bagti të imta me lesh dhe 200 kafshë me brirë. Vranë 45 veta; Zenel Halili, Qazim Sulejmani, Emin Fejzullahu, Sulejman Mahmuti, Ismail Bajrami, Tahir Bajrami, Ibrahim Sulejmani, Jonuz Lika, Sait Ibrahim, Fazli Ismaili, Xheladin Sinani, Dalip Fetahu, Vesel Idrizi, Hysen Fetahu, Dalip Sulejmani, Jakup Idrizi, Hasan Bajrami, Sali Tahiri, Jashar Selmani, Nuredin Hasani, Destan Selmani, Jashar Xhaferi, Ramadan Dalipi, Muhtar Isufi, Muharrem Islami, Sefedin Ibrahim, Hasan Sulejmani, Sinan Rama, Muhtar Emiri, Selman Maksuti, Ismail Bajrami, Ramadan Nimani, Adem Veseli, Xhafer Osmani, Osman Dalipi, Tahir Sulejmani, Daut Ibrahim, Mehmet Destani, Veli Bajrami dhe Esat Nimani.

Në Çatush

Dogjën 4 shtëpi, rrëmbyen 3 kuaj, dhe vranë Hamza Hasanin, Zenel Shabanin, Osman Nimanin.

Në Brezhdan.

-Plaçkitën e dogjën 17 shtëpi. Vranë Abe-

din Osmanin, Shahin Mahmutin, Sali Kadri, dhe rrëmbyen 25 kuaj.

Në Ushtelenxë.

-Bënë rrëmujë tërë fshatin dhe dogjën 13 shtëpi. Vranë Niman Rustemin, Musli Zequn dhe Mehmet Gotën. Rrëmbyen 17 kuaj dhe 5 lopë.

Në Deshat.

-Dogjën 15 shtëpi, dhe hodhën të gjallë në zjarr një djalë 10 vjetësh Ramiz Mustafën, një shtatë vjetësh Xhafer Bajramin, një djalë tjetër Lut Mahmutin dhe dy gra: Mahmuden dhe Safijen. Rrëmbyen 50 lopë dhe 500 dele.

Në Sohodoll.

Dogjën 3 shtëpi dhe vranë me bajoneta Abdulla Abedinin Tosun Dalipin, Sulejman Baftjarin, Dalip Ismailin, një grua Belurenë dhe të birin e saj 6 vjetësh Mazllumin. Rrëmbyen 200 krerë bagti dhe 30 kuaj.

Në Borovjan.

-U vunë zjarrin dy shtëpive dhe therën Rustem Muharremin ndër sy të fëmijës së tij. Rrëmbyen 37 krerë lopë, 119 dhen e dhi si dhe 5 kuaj.

Në Rashnapojë.

-Nuk dogjën asnjë shtëpi por të gjitha i bënë rrëmujë. Vranë Bajram Mehmetin, Malik Rakipin, Selman Rakipin, Bexhet Belulin, Osman Azamin, Hajredin Malikin. Rrëmbyen dhe 20 lopë.

Në Cerjan.

-Vranë me bajoneta Fazli Sulejmanin, Jashar Hejbetin, Bektash Asllanin dhe një grua Zobeida. Rrëmbyen 14 kuaj dhe 60 berra.

Në Pilafe.

-Plaçkitën fshatin. dogjën 5 shtëpi dhe vranë në sy të nënës Dalip Ramadanin

# Piloti dibran që shpëtoi Lushnjen nga katastrofa

Nga SHAQIR SKARRA

Sefedin Tomçini atë natë qershori kish 35 vjetorin e lindjes. E gjithë shtëpia e tij e kishte organizuar bukur këtë festë familjare. Suzana e shoqja ishte mjaft e përkushtuar për këtë darkë jo vetëm familjare. Ishin blerë dhe dhuratat por dhe pijet e çastit. Ishin njoftuar dhe ato që do të vinin në këtë gëzim familjar. Dy vajzat e Sefedit ishin të vogla. Më e madhja Elda nuk kuptonte me këto pregaditje që po bëheshin në shtëpinë e saj. Sefedini u nis herët në mëngjes. Si çdo ditë duke puthur në ballë vajzat e vogla. U nis se do të kthehej më herët se ditët e tjera. Ishte e martë dhe dita e nesërme ishte pushim. Bashkë me miqë dhe shokë do të festonte ditëlindjen. Kur të kthehej nga fluturimi do të shkonin bashkë me Suzanën për urim tek një shok tjetër i cili dhe ky kishte ditëlindjen pastaj do të ktheheshin të pregaditnin gjërat e nevojshme për këtë përvjetor por që nuk u festua kurrë. Atë natë kishte qëndruar deri vonë duke u pregaditur. Kishte lexuar dhe gazetën si çdo natë dhe kishte rënë gjumë. -Shpeshherë ndodhte tregon Suzana që Sefedini ditën që kishte fluturim dhe vajzat e vogla qanin natën flinte në guzhinë. Mirpo pilotët kanë dhe të papriturat por askush nuk mendonte se në shtëpinë e Hasan Tomçinit do të ndodhte gjëma dhe kur pikërisht një ditë më pas do të festohej përvjetori i lindjes. E gjëma nuk mund të izolohet, ajo i kalon caqet e çdo gjëje. Suzana kishte dalë jashtë me vajzat e vogla për dore që të priste Sefedinin nga puna pasi ora kishte kuar tre pas dite kur sytë iu errësuan. Drejt hyrjes së saj një kortezh i gjatë me koka ulur përdhe. Gjëma merret vesh, duket në sytë e të tjerëve. Fjala vajti dhe në shtëpinë e Hasanit në Pollozhan. Në gjithë e kapërdinë të keqen që u ndodhi megjithëse të dy pleqtë u kërrusën dhe më shumë.

Në Pilafë mëhallë  
Dogjën 8 shtëpi dhe vranë me bajoneta Hasan Fetahun, Sali Jusufin dhe një vajzë 6 vjeçe Fatimen. Hodhën të gjallë në zjarr një djalë 5 vjetësh Shukriun dhe një katër vjetësh Hasanin. Rrëmbyen 115 bagti me brirë, 200 dhen e dhi dhe 3 kuaj. Në Pollozhan.  
-Plaçkitën fshatin dhe dogjën 3 shtëpi. Vranë Hajredin Veshtën dhe të vëllanë Azizin, Jusuf Ukën, Hajredin Shkurthin Husein Zejnelin Hajredin Halilin, Seit Pashën, Emin Shahinin, Elez Nimanin dhe të vëllanë Osmanin. Rrëmbyen 50 dele, 12 qe, 4 kuaj.  
Në Bllaç.  
-Dogjën 5 shtëpi dhe therën Xhafer Rustemin, Destan Hasanin, Xhemal Saliun dhe një grua Aishe. Rrëmbyen përmbi 250 dhen dhe 3 kuaj.  
Në Limjan.  
-Plaçkitën fshatin dhe vranë kot e pa punë Hasan Shahinin, Sejfulla Ibrahimin, Abdurraman Fetahun, Qerim Sadikun, Bajram Xhelilin. Rrëmbyen 200 berra, 20 lopë, 10 kuaj.  
Në Trepçë.  
-Bënë rrëmujë fshatin dhe vranë përpara syve të fëmijës Zejnulla Ahmetin. Rrëmbyen 2 kuaj, 57 berra.  
Në Çidhën.  
-Dogjën 30 shtëpi dhe ndër të vranët janë: Xhetan Kaloshi Hasan Hani, Asllan-Sadiku, . Rrëmbyen 500 krerë bagëti, 20 krerë me brirë, 13 kuaj  
Në Venisht.  
-Plaçkitën fshatin dhe vranë Beqir Asimin dhe Idriz Tahirin. Rrëmbyen 400 berra, 6 kuaj 10 lopë.  
Në Trojak. -Dogjën një shtëpi dhe muarën 5 kuaj.  
Në Dypjakë.  
-Fshati u bë plaçkë dhe gjindja për të



Gruaja e tij Suzana u vesh me të zeza dhe u betua se do të qëndronte në këtë shtëpi e të rriste dy vajzat që i mbetën jetime. Elda dhe Arlinda nuk kuptonin gjë për fatkeqsinë që u kishte ndodhur. Po kush ishte piloti Sefedin Tomçini sot dëshmor i atdheut, djali nga Pollozhan i Dibrës që me heroizmin e tij bëri që atëherë të mbushnin faqet gazetave e ndryshme. Lindi më 7 qershor të vitit 1942 në Pollozhan. Ishte i dyti mashkull në një familje të mbushur me fëmijë dhe ardhja e tij përbënte gëzim të madh për familjen e Hasan Tomçinit i cili ishte vetë mashkull i vetëm në trunqun familjar. Hasanin ishte rritur binjak dhe më shumë vështirsi. Babën ia patën pushkatuar serbët. Atë i patën djegur dhe shtëpinë duke e lënë nënën e tij në mes të katër rrugëve me pesë fëmijë të vegjël. Sefedini që i vogël dallohej nga moshatarët e tij. Ishte më i shkathët dhe ngjitej për zbavitje në majën më të lartë të pemëve të fshatit. Dy klasë të shkollës filllore i bëri në Tomin

shpëtuar nga vrasja dhe nga zjarri i pagoi kumandarit të serbëve një shumë prej 45 lira turke. Vranë vetëm një njeri Beqir Sulejmanin dhe muarën 10 kuaj, 60 berra dhe 10 lopë.  
Në Sllatinë.  
-Dogjën 30 shtëpi dhe hodhën të gjallë në zjarr Baftjar Idrizin. Rrëmbyen 1300 kokë bagëti, 35 lopë, 25 kuaj.  
Në Vleshë. -Pas të plaçkiturave dogjën 40 shtëpi dhe vranë Zaim Hysenin, Abaz Idrizin, Sali Kadriun. Rrëmbyen 600 dhen e dhi, 35 lopë, 18 kuaj.  
Në Kallë.  
-Dogjën 30 shtëpi. Therën në prag të derës Bajram Rustemin dhe dogjën të gjallë një grua Daveshën. Muarën 50 krerë qe dhe lopë, 500 krerë bagti, 16 kuaj.  
Në Sllövë.  
-U vunë zjarrin 32 shtëpive, pasi bënë rrëmujë tërë fshatin nuk vranë njeri se gjindja me të dëgjuar mënyrat të fshatrave të tjerë nuk i zunë besë amnistisë dhe ikën ndër male. Gjetën ndër fshat 10 lopë, 300 berra.  
Në Dardhë.  
-Plaçkitën fshatin dhe vranë me bajoneta Nuredin Sulejmanin dhe Ramadan Sinanin. Rrëmbyen 80 lopë e qe dhe 300 dhi.  
Në Reç.  
-Muarën gjithë çfarë gjetën dhe sidomos 500 berra dhe 100 lopë e qe.  
Në Shumbat.  
Dogjën 5 shtëpi dhe vranë me bajoneta tri gra Rihanen, Selvien dhe Aishen dhe tre burra Jusufin, Bajramin dhe Bajramin. Rrëmbyen 730 krerë dhen 415 krerë dhi dhe 21 kuaj.  
Në Palaman.  
-Dogjën 3 shtëpi dhe rrëmbyen 5 kuaj dhe 20 lopë e 150 bagti.



i shkollës së mesme iu mbush mendja të bëhej pilot. Të gjithë u habitën me këtë iniciativë të djaloshit nga Pollozhan por askush nuk jep detaje se si i lindi kjo ide por dihet se atë vit në Peshkopë u kërkuan disa kandidatura të mundshme për në shkollën e pilotimit. Bashkë me Sefedinin u nisën për në Tiranë dhe disa djelmosha të tjerë për të bërë analizat e nevojshme mirpo në fakt të gjithë u kthyen prapë dhe këtu fitoi vetëm Sefedin Tomçini. Prindërit dhe sidomos vëllai i tij Sulejmani i cili në këtë kohë vazhdonte Universitetin nuk ia bënë mbarë por Sefedini u nis në rrugën e bukur të qiellit pa pëlqimin e familjes. Në shtator të vitit 1960 shkon në shkollën ushtarake për pilot në Batajsk të ish Bashkimit Sovjetik por nuk qe e thënë që këtë shkollë ta mbaronte këtu. Ishte pikërisht ky vit që marrëdhënjet mes dy vendeve u prishën. Kthehet në atdhe dhe vazhdon shkollën e pilotimit në qytetin bregdetar të Vlorës të cilën e mbaroi me nota të shkëlqyera në vitin 1963 ku u caktua si oficer pilot në regjimentin e Forcave të Armatosura Ajrore në Rinas. Sefedini e vlersonte shumë profesionin që kishte zgjedhur dhe ishte i lidhur shumë me të. Kohën e kishte mjaft të kufizuar por gjente dhe për tu kujdesur për familjen. Në kohë pushimesh shkonte dhe në fshatin e lindjes në Pollozhan. Atje e prisnin të gjithë jo vetëm fshati i lindjes por dhe fshatrat përreth qytetit të Peshkopisë. Sefedini ishte njeri me humor dhe tepër i dashur me të gjithë. Këto tipare të bukura të tij i tregojnë shokët dhe kolegët në përvjetorët që ia kanë festuar. Megjithëse i përjetonte me dhimbje aksidentet e shokëve ai asnjëherë nuk u ligështua përballë fatkeqsive. Kur u vra Niko Hoxha, komandanti trim i Regjimentit të Rinasit Sefedini u ndodh aty nga të parët dhe u mundua që t'i jap ndihmën e tij. Hoqi xhupin e tij prej meshini e ja hodhi sipër kolegut të tij që po digjej. Megjithëse kjo vrasje nuk ia hoqi pezmin e hidhërimit ai nuk e



1. Sefedin Tomçini para avionit
2. Me gruan, Suzanën dhe vajzën, Eldën.
3. Dita e martesës

urrejti asnjëherë profesionin e tij, profesion të cilin u vertetua plotsisht se e kishte dashur me jetën. Njëherë tregon Suzana ishim në plash. Sapo kishim dalë nga deti dhe po rrimin të qetë në rërë.

Mbi qiell po fluturonte një aeroplan "Mig" Sefedini e la gazetën dhe hodhi sytë nga qielli duke ndjekur kolegun e tij që kishte radhën e fluturimit-Sa të lumtur janë këto pilotët që fluturojnë. Ato janë zotër të tokës dhe qiellit. Sefedini ishte një pilot i pregaditur mirë. Ai fluturonte në lartësi të mëdha dhe në kohë të keqe. Ishin të veshitura ushtrimet që bënte në ajër por ai asnjëherë nuk dështoi. Edhe kur bënte gjuajtje ai manovronte me kujdes, ulje në distancë të afërt dhe gjuante objektivin E këshillonin gjithmonë miq dhe shokë që të kishin kujdes. Është profesion që nuk të fal dy herë i thonin. E Sefedini buzagaz u kthehej.


-Mos kini frikë. Unë kam engjël tim mbrojtës që më mbron nga rreziqet, dhe ky mbrojtës është parashuta ime. Ai ishte shumë i dashur dhe çiltër me shokët. Një miqsi tepër vëllazërore e lidhte me pilotin tjetër dibranë Sabri Toçin me të cilin kishte punuar në Rinas ku edhe ky vetëm pak vite më vonë ra në krye të detyrës në moshë fare të re. Viti 1969 ia ndryshoi jetën Sefedini. Në këtë vit marotohet me një vajzë gjirokastrite ku dasmën e bëri në fshatin e Pollozhanit. Suzana ende i kujton ato momente të bukura të dasmës në Dibër. -Jeta e pakët me Sefedinin për mua vazhdon Zana ka qenë një shkollë e vërtetë. Megjithëse kishte punë dhe vinte tepër vonë në shtëpi gjente kohë të merrej dhe kujdesej dhe për familjen. Ishte këmbëngulja dhe iniciativa e tij që unë fillova të vazhdoja studimet e larta. Kënaqsi kishte kur dilte xhiro në qytet me Eldën për dore. Atëherë ajo ishte e vogël vetëm gjashtë vjeçe dhe kishte mjaft dëshirë që ta shikonte të vazhdonte shkollën por nuk e pati atë fat. Data 7 qershor 1977 Sefedin Tomçini fluturon mbi qytetin e Lushnjës. Avioni Mig 19 krijon difekt. Si gjithmonë edhe në këtë rast e ruajti gjakftohësinë. Avioni ishte i mbushur me armë dhe predha. Po të binte mbi Lushnje do të kishte ndodhur një katastrofë e vërtetë. E ndryshoj me kujdes dhe gjakftohësi avionin në një fushë të gjërë në Pluk të Lushnjës dhe vetë bëri pregaditjen e hedhjes me katapultë. E engjëlli i tij mbrojtës këtë radhë nuk iu bind, nuk iu bind që piloti Sefedin Tomçini të mbetet një hero i gjallë për atë që bëri jo vetëm për Lushnjen por për gjithë vendin. Parashuta nuk iu hap. Sefedin Tomçini ra në krye të detyrës duke shpëtuar kështu një qytet të tërë, Edhe sot banorët e këtij qyteti myzeqar i janë mirënjohës pilotit dibranë Sefedin Tomçinit. Kështu u nda nga jeta ky bir i Pollozhanit duke shkruar një faqe tjetër të ndritur në historinë e Dibrës.

## Huzri Hoxha i rikthehet pikturës

Më datën 5 dhjetor në një nga sallat e muzeut historik në kryeqytet u hap ekspozita vetjake e piktorit dibran Huzri Hoxha. Ekspozita e pikturës me pamje më së shumti nga treva e Dibrës u hap nën përkujdesjen e shoqatës "Lidhja e intele-

ktualëve dibranë" Ishin të pranishëm deputetët Baki Shehu, Gëzim Karapici, Sali Shehu, Rahim Kaleci si dhe prefekti i Dibrës zoti Xhafer Saiti. Në emër të shoqatës përshëndeti kryetari i saj zoti Nuri Abdiu. Kjo është ekspozita e dytë e piktorit dibran Huzri Hoxha. Ekspozitën

e parë e ka hapur atëherë kur ishte student. Huzriu si biznesmen tashmë edhe piktor dhe arti i tij në pikturë anon më së shumti në portret e cila është dhe më e vështirë. Artëdashësit shqiptar mirëpresin të tjera ekspozita nga Huzriu. Ai tashmë është afirmuar si i tillë.



"Skënderbeu". H. Hoxha

## Gazmend Kërkuti, dibrani që bën të njohur Dibrën në gjithë skajet e botës

Kushdo që ka provuar të kërkojë të dhëna në internet për Dibrën, ndër emrat e parë që të dalin është ai i Gazmend Kërkutit. Foto nga mbarë Dibra dhe në shumë faqe interneti në botë mbajnë firmën e tij. Jo vetëm kaq, por një faqe e tërë i n t e r n e t i , "www.dibra.org", faqja zyrtare e shoqatës atdhetare dibrane në New York, mirëmbahet prej tij.

Gazmend Kërkuti nuk është një emigrant i thjeshtë në Amerikë. Ai është një qytetar Dibran, i cili mendon dhe vepron për Dibrën. Një sërë fotografishë të publikuara së fundi mbanin nëntitullin "Suport për Rrugën e Arbërit".

Kohët e fundit, Gazmend Kërkuti, bashkë me miq të tij nga qyteti i Dibrës së Madhe, kanë bërë një DVD me pamje fantastike nga Dibra. Bukuritë e Dibrës janë hedhur në një film prej gati 2 orësh, duke treguar kështu se Dibra mban të fshehura vlera turistike e të panjohura më parë në Shqipëri. "Dibra në HD" është një guidë turistike që i ofrohet çdo qytetari të botës pa pagesë dhe kjo falë përkushtimit të Gazmendit dhe dashurisë së tij për Dibrën.



DVD e Dibres eshte perfunduar!



Te gjithëve atyre personave qe u kame premtuar apo pranuar adresat e bani mit, sot me 28 Nentor i kam postur me se 100 DVD. ( ne Diber, ne Shqiperi, Italy, Suedi, Floride, Kanada, Arizone etj...)

Metevrt jam shume i kenaqur nga vleresimi i njerzve qe kane shikuar kete DVD si test, kjo me inspiron qe te bej projekte te tjera ne te ardhshmen.

Nese nuk keni kontakte me Dibrane te tjere ne qytetin ku ndodheni me kontaktoni ne gj.mannw@gmail.com do mundohem tju ndihmoj.

Edhe nje here e perseris, DVD lejohet te kopjohet...por JO te shitet! E kame bere FREE per krejt Dibranet qe e duan Dibrën!

GK

## FALENDERIM

Këto ditë sapo ka dalë në qarkullim edicioni i pestë i kalendarit "Dibra 2007". Kalendarin përmban foto të të gjitha trevave të Dibrës, duke u kthyer në një botim vjetor, ku publikohen foto me vlera turistike, etnografike e historike të Dibrës.

Por ky botim, u bë i mundur edhe falë ndihmës që dhanë shumë fotografë dibranë dhe jo dibranë si: Ing.Bashkim Lleshi, Gazmend Kërkuti, Argjend R. Kaba, Rexhep Ndreu, Fatmir Karameti, Defrim Marku, Gentian Vraniçi, Ali Pira, të cilët Shtëpia Botuese "m&b" i falenderon.

Gjitashtu, falenderimi është edhe ata dibranë që sollën fotografi të tyre për kalendarin "Dibra 2007", por që nuk u botuan në këtë edicion të kalendarit. Fotot e tyre, redaksia i ka përzgjedhur për botime të tjera me fokus Dibrën dhe turizmin dibran.

Shtëpia Botuese "m&b" falenderon edhe firmën "Aurora Group" me president z.Rakip Suli dhe Librarinë "Fleta XXI" në Peshkopi për mbështetjen që i kanë dhënë botimit të këtij kalendarit në vite.

## Poezia e Kozeta Zylos për dibranët

### "FALEMINDERIT DIBËR"

Edhe pse asnjëherë nuk e kam prekur tokën tënde  
Ti bijën tënde e ndjen pranë  
Sot më vlerësove me çmimin e mirënjohjes,  
Unë nesër do ta shpërblej me shkronjat shqipe  
në çdo anë

O Dibër historike e burrave të shquar,  
Që kurrë nuk ndale për arsim e dituri,  
Edhe pse kohrat ta shqyen trupin,  
Ti në plagë e dhimbje thërrisje, Shqipëri!

Si gjerdan të çmuar rreth trupit tënd,  
I mbledh mësuesit në këtë ditë të shenjtë,  
Me alfabetin e shqipes, gjuhën e Zotit,  
Bashkohen shqiptarët, qysh prej qemotit.

Me fisnikërinë e shpirtit, në zemrën tuaj,  
I hapet krahët e shqipes në fluturim,  
Si fole shqiponje në dhe të huaj,  
Na mblodhe Dibër, o vellezër të gjakut tim.

E kush, kush mund të vlerësojë më shumë,  
Se gjuha tënde rrënjë të një trugu,  
Të tjerët mund të japin çmime e dekorata,  
Por ti ndihesh si një kodër e mbuluar nga muzgu.

Në ditën e sotme ju mësuesit çmoni,  
Edhe pse lidhjet, e kaluara na i preu,  
Në prushin e zemrës shkronjat i ruajtët,  
Faleminderit Dibër, me gjak Skënderbeu!

Keze (Kozeta) Zylo, NY  
Mars, 2006

www.dibra.org